



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

**GJYKATA THEMELORE PEJË**

---

**AD/GJTHPE/.nr.15/23**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**, me Kryetarin e Gjykatës Armend Berisha, në procedurën disiplinore ndaj gjyqtarit B.Sh, duke vepruar sipas ankesës disiplinore të parashtruar nga B.H, rruga “E. L. E.”, nr..., Pejë, pas shikimit të shkresave dhe vlerësimit të ankesës, jashtë seancës, me datë 18.01.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** ankesa disiplinore e parashtruar nga B.H, nga Peja, ndaj gjyqtarit B.Sh, **SI E PABAZUAR.**

**A r s y e t i m**

Me datë 21.12.2024, B.H, me banim në rrugën “E. L. E.”, nr.13, në Pejë, ka parashtruar ankesë disiplinore ndaj gjyqtarit B.Sh, për shkak të shkeljeve disiplinore nga neni 3 lidhur me nenin 5 par.2 nënpar.2.1, 2.2, dhe 2.8 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, me arsyetimin se këtu parashtruesi i ankesës, në cilësinë e palës së paditur në lëndën C.nr.1025/22, me datë 18.10.2023 ka dorëzuar në gjykatë kërkesë për dërgimin e padisë dhe shkresave të saj, për të cilën kërkesë gjyqtari ende nuk ka vendosur. Duke shtuar se në seancën e datës 07.11.2023, gjyqtari i ka dhënë këshilla avokatit se si të veproj dhe ka konstatuar në procesverbal fjalë që i padituri nuk i ka thënë e po ashtu, seanca gjyqësore është mbajte në zyrën e gjyqtarit e jo në sallë të gjykimit, gjatë seancës i padituri B.nuk ka pas tavolinë pune dhe lëndën e ka lënë në dyshemenë e zyrës gjë e cila i vë në rrezik shëndetin dhe se në zyrë nuk ka kushte minimale për një shqyrtim kryesor të paanshëm, të drejtë, duke vepruar kështu me paragjykimë në bazë të pronës, gjendjes ekonomike dhe sociale, aftësisë së kufizuar të paditurit B.H. Përmes të njëjtës parashtrësë, me arsyet si më lartë ankuesi në cilësinë e të paditurit ka kërkuar edhe përjashtimin e gjyqtarit B.Sh nga gjykimi dhe vendosja në çështjen civile ku i njëjti është palë si dhe përjashtimin e Kryetarit të Gjykatës nga vendosja lidhur me kërkesën për përjashtim të gjyqtarit.

Me datë 22.12.2024, Kryetari i Gjykatës duke vepruar në kuptim të nenit 9 par.5 të Ligjit mbi Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve e ka njoftuar Këshillin Gjyqësor të Kosovës për pranimin e ankesës disiplinore të parashtruar nga B.H, ndaj gjyqtarit B.Sh.

Me datë 27.12.2023, kërkesa e të paditurit për përjashtim të Kryetarit të Gjykatës është dërguar në Gjykatën e Apelit për vendosje, e cila gjykatë me Aktvendim ka refuzuar kërkesën për përjashtim të Kryetarit të Gjykatës.

Gjyqtari B.Sh, në deklaratën e tij ka theksuar se lidhur me kërkesën e të paditurit, këtu parashtruesit të ankesës disiplinore, që t’i sigurohen shkresat e lendes të njëjtit gjykata i ka dorëzuar një kopje të të gjitha shkresave të lëndës për çka si dëshmi gjendet fletëkthesa që e dëshmon pranimin e shkresave nga pala. Ndërsa sa i përket pretendimit të ankuesit se seanca është mbajte në zyrën e gjyqtarit dhe pala nuk ka pas tavolinë pune, gjyqtari ka deklaruar se duke i pasur parasysh kushtet e gjykatës në të cilat

punohet nuk ka pasur asnjë privilegj në raport me palët tjera pasi që edhe palët tjera nuk kanë pasur tavolinë pune e as ndonjë tretman tjetër, pra nuk ka të bëjë kjo çështje fare me aspektin e diskriminimit siç pretendon pala ankues. Gjithashtu nuk qëndron pretendimi se gjyqtari i ka dhënë këshilla të autorizuarit të paditësit, ky pretendim është vetëm një pretendim imagjinar i të njëjtit në atë mënyrë që të vë gjykatën në presion ku dhe të gjitha pretendimet e të njëjtit janë vetëm me qëllim të ushtrimit të presionit në raport me gjyqtarin e çështjes. Përfundimisht, ka shtuar se për tu konsideruar si shkelje disiplinore veprimet e gjyqtarit të cekura më lartë duhet të bëhen me dashje dhe të argumentohet dashja, apo të paraqiten prova konkrete që paraqesin apo argumentojnë dashjen për të vepruar kundërligjshëm apo shkeljen e detyrave zyrtare siç pretendon ankuesi mirëpo të gjitha te cekurat në ankesën e tij nuk qëndrojnë.

Kryetari i Gjykatës duke vlerësuar ankesën e parashtruar ndaj gjyqtarit B.Sh, së bashku me deklaratën e tij, ka gjetur se ankesa disiplinore është dukshëm joserioze dhe e pabazuar.

Autoriteti kompetent gjen se ankesa disiplinore me pretendime të njëjta, me datë 27.11.2023, është parashtruar nga i paditurit tjetër M.H., të cilat pretendime janë refuzuar si dukshëm joserioze dhe të pabazuara me Aktvendimin AD/GJTHPE/.nr.12/23, të datës 13.12.2023.

Andaj, autoriteti kompetent në rivlerësim të pretendimeve të mësipërme gjen se pretendimet se gjyqtari e ka këshilluar avokatin e palës tjetër apo se ka konstatuar në procesverbal fjalë që i padituri nuk i ka thënë e pretendime të tjera të ngjashme, nuk i ka argumentuar me asnjë provë, përkundrazi i njëjti në ankesën e tij vetëm ka cituar dispozitat e Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarë që përcaktojnë shkeljet disiplinore të gjyqtarëve, por të njëjtat nuk i ka arsyetuar dhe nuk i ka argumentuar me asnjë provë.

Sa i përket pretendimeve të parashtruesit të ankesës se gjatë seancës nuk ka pas tavolinë pune dhe është trajtuar me paragjykime, autoriteti kompetent gjen se të njëjtat janë dukshëm joserioze duke pas parasysh se është fakt i ditur se si pasojë e infrastrukturës së objektit të Gjykatës një numër i konsiderueshëm i seancave gjyqësore mbahen në zyra të gjyqtarëve, të përshtatura me qëllim të ofrimit të kushteve elementare për mbajtjen e seancave gjyqësore ashtu që në asnjë zyrë e madje, në asnjë sallë të gjykimit, nuk ekzistojnë kushte të atilla që ia mundësojnë gjyqtarit ofrimin e komoditetit apo ofrimin e tavolinave të veçanta për njërën palë.

Andaj, nga arsyet e theksuara me lartë, konform dispozitave ligjore të nenit 9 par.6 të Ligjit mbi Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, dhe nenin 7 par.3 pika 3,1 dhe 3.2 të Rregullores të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nr.05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve u vendos si ne dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË, AD/GJTHPE/.nr.15/23, me datë 18.01.2024.**

**Kryetari i Gjykatës**

---

**Armend Berisha**

*Vendimi i dorëzohet:*

- 1. Këshillit Gjyqësor të Kosovës*
- 2. Gjyqtarit B.Sh*
- 3. Parashtruesit të ankesës – B.H*